

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5518
E enjte, 5 korrik 2018
çmimi 0.40 €

Amerika shënon
242-vjetorin
e pavarësisë FAQE 11



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEKIM JASHARI FAQE 4-5

Po e kthejmë besimin e qytetarëve në Skenderaj

- Deri më tani punët kanë ecur mirë dhe jemi në drejtim të realizimit të qeverisjes transparente dhe llogaridhënese

Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, është shprehur i kënaqur me qeverisjen e deritanishme në këtë komunë, por ka thënë se ende ka shumë për t'u bërë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se është duke punuar në mënyrë transparente dhe duke dhënë llogari para qytetarëve për çdo vendim. Pavarësisht prej sfidave, ai ka premtuar se do ta vazhdojë realizimin e projekteve që përmirësojnë jetën e qytetarëve. Jashari ka treguar se është duke u punuar maksimalisht për ta kthyer besimin e qytetarëve në Komunën e Skenderajt. Ai ka bërë me dije se deri më tani punët kanë ecur mirë dhe janë në drejtim të realizimit të qeverisjes transparente dhe llogaridhënese. Jashari ka thënë se Komuna e Skenderajt ka bashkëpunim të mirë me të gjitha institucionet e nivelit qendror



AKTUALE

**PROBLEME
THEMELORE TË
PUNIMEVE
STUDIMORE**



F. 11
Hajdin ABAZI

**BIE NUMRI I AKSIDENTEVE
NË TRAFIK** F. 5

**APOSTOLOVA KËRKON QË
NGRITJA E CILËSISË NË
ARSIM TË NISË NGA
REFORMAT NË MASHT** F. 6

EKONOMI

**LLUKA: NGA 5.5 MILIONË
EURO, VLERA E
SHPRONËSIMEVE
U RRIËT 27 MILIONË EURO** F. 9

**AKP-ja TRANSFERON
MBI 42 MILIONË EURO NË
FONDIN E KOSOVËS** F. 9

KULTURË

**SHUMËLLOJSHMËRIA E
ESESË** F. 13

Idriz BERISHA

SPORT

**GASHI: PALESTRA NË
SAMADREXHË PËRFUNDON
KËTË VIT** F. 15

**PRISHTINA E SIGURT DREJT
SUKSESIT HISTORIK** F. 15

Nëse zgjedhjet parlamentare do të mbaheshin të dielen e ardhshme, a do të votonit?
VETËM VOTA E DEKLARUAR



INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI) KA PUBLIKUAR REZULTATET E SONDAZHIT NË LIDHJE ME DIALOGUN KOSOVË - SERBI DHE PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE

Sondazhi: LDK-ja para PDK-së, Nisma ka rritje

FAQE 7

Nga sondazhi i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), i cili është publikuar të mërkurën, ndër disa pyetje janë edhe rezultatet për subjektet politike nëse

zgjedhjet do të mbaheshin tani. 30.8 për qind e të anketuarve kanë thënë se do të votonin për LDK-në, 23 për qind për PDK-në, 21.2 për qind për LV-në, 10.4

për qind për AAK-në, 6.3 për qind për Nismën, 2.4 për qind për PSD-në, 2 për qind për Listën Serbe dhe 4.1 për qind të tjera

Asociacioni pritët ta vështirësojë fazën finale të dialogut

FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Amerika shënon 242-vjetorin e pavarësisë

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë shënuar të mërkurën Ditën e Pavarësisë, 242-vjetorin e shkëputjes nga Britania me piknikë, parada dhe fishekzjarr në gjithë vendin. Liderët shtetërorë të Kosovës kanë uruar për Ditën e Pavarësisë duke u zotuar se do të ruhen marrëdhëniet speciale me ShBA-në



UASHINGTON, 4 KORRIK - Shtetet e Bashkuara kanë festuar të mërkurën Ditën e Pavarësisë. Këtë vit amerikanët shënojnë 242-vjetorin e shkëputjes nga Britania me piknikë, parada dhe fishekzjarr në gjithë vendin. Presidenti Donald Trump dhe Zonja e Parë, Melania, kanë mbajtur një piknik për familjet e ushtarakëve në Shtëpinë e Bardhë.

Festa e 4 korrikut përfshin traditën e leximit të Deklaratës së Pavarësisë në shkallët e Arkivave Kombëtare në Uashington. Brenda godinës, dokumenti origjinal është i ekspozuar së bashku me Kushtetutën dhe Kartën e të Drejtave.

Pas leximit, fillon një paradë para ndërtesës së Arkivave në shëtitoren e quajtur Constitution (Kushtetuta) dhe vazhdon deri në zonën në mes të Shtëpisë së Bardhë dhe monumentit për nder të presidentit të parë amerikan, George Uashington. Mijëra veta dalin nëpër rrugë për ta ndjekur paradën.

Në Uashington mbahet gjithashtu një koncert para selisë së Kongresit, Kapitol, ku interpretojnë grupe dhe këngë-

tarë të njohur dhe Orkestra Simfonike Uashingtonit. Festimet mbyllen me një shfaqje madhështore fishekzjarrësh, pas perëndimit.

Për shkak të zjarreve të mëdha që po përhapen në perëndim të ShBA-së, ekziston një shqetësim i madh se fishekzjarrët në Ditën e Pavarësisë do të shkaktojnë zjarre dhe është vendosur që për shkak të sigurisë, në qiell të përdoren vetëm dronë.

Një lloj i tillë i festimit do të organizohet në qytetin Kerfri dhe në Arizonë, transmetojnë mediet amerikane.

Në 242-vjetorin e pavarësisë, ShBA-në e kanë uruar liderët shtetërorë të Kosovës, presidenti Hashim Thaçi dhe kryeparlamentari Kadri Veseli.

Thaçi: Do t'i ruajmë marrëdhëniet tona speciale me ShBA-në

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka uruar Shtetet e Bashkuara të Amerikës për 242-vjetorin e pavarësisë së tyre. Sipas tij, 4 Korriku është gjithmonë një ngjarje e veçantë dhe emocionale për qytetarët e

Kosovës. Në një postim në "Facebook", Thaçi ka rikonfirmuar zotimin e Kosovës për ruajtjen e marrëdhënieve speciale me ShBA-në. "Në Kosovë, festimi i 4 Korrikut, Ditës së Pavarësisë së ShBA-së, është gjithmonë një ngjarje e veçantë dhe emocionale. Kështu ka qenë, kështu është tani dhe kështu do të mbetet për gjithmonë sepse liria jonë, vlerat tona, janë të mishëruara me ato të popullit amerikan", ka shkruar Thaçi. Ai ka thënë se modeli amerikan i ndërtuar mbi lirinë individuale, bashkëjetesën ndërmjet popujve dhe komuniteteve të ndryshme, ndarje të pushteteve dhe llogaridhënie, sundim i rendit dhe ligjit janë

edhe vlera që ndërtojmë dhe promovojmë edhe ne në Kosovë. "Mirënjohjen tonë e shprehim duke punuar për paqen, fqinjësinë e mirë si parakushte të domosdoshme për integritet euroatlantike. Në emër të qytetarëve të Republikës së Kosovës uroj popullin amerikan Ditën e Pavarësisë dhe rikonfirmoj zotimin tonë për ruajtjen e marrëdhënieve tona speciale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, miqësinë tonë të përhershme dhe aleancën tonë në vlerat dhe parimet që na bashkojnë", ka shkruar presidenti Thaçi. Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh lider i PDK-së, Kadri Veseli, ka uruar pop-

ullin amerikan me rastin e 242-vjetorit të pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Veseli në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Kosova dhe qytetarët e saj janë krenarë me Amerikën.

Ditën e Pavarësisë së ShBA-së e ka uruar edhe kreu i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, duke thënë se qytetarët e Kosovës e përjetojnë me ndjenja të veçanta respekti 4 Korrikun, Ditën e Pavarësisë së ShBA-së. Mustafa ka theksuar se Republika e Kosovës dhe qytetarët e saj do t'i jenë përjetë mirënjohës ShBA-së për rolin vendimtar në lirinë, pavarësinë dhe ndërtimin e shtetit të Kosovës.

Xhaferi: Ballkani Perëndimor mund të gjejë zgjidhje për çdo problem

SHKUP, 4 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi, mori pjesë në Konferencë me temë "Sfidat bashkëkohore të hapësirave transatlantike" që u mbajt në Kroaci, e organizuar nga Bashkimi Atlantik i Kroacisë Hanns-Seidel-Stiftung, në bashkëpunim me Institutin për Zhvillim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Në konferencën dyditore, që filloi në ishullin Shipan, e cila është projektuar për 30 liderë nga vendet e rajonit, Xhaferi ligjëroi dhe ndau një pjesë të përvojës së vet profesionale, kurse foli edhe për aktivitetet e tanishme në Republikën e Maqedonisë dhe të rajonit. Xhaferi theksoi se Ballkani Perëndimor, sipas standardeve

dhe vlerave që më shumë mbisundojnë, bëhet pjesë e asociacioneve euroatlantike. Ai shton se të gjithë në rajon mund të ofrojnë bashkërisht zgjidhje të pranueshme për secilën problem apo zgjidhje të ndonjë çështje, vetëm përmes dialogut dhe bashkëpunimit të hapur, posaçërisht kur bëhet fjalë për sfidat e përbashkëta.



Tërmet 5,1 shkallësh në Tiranë

TIRANË, 4 KORRIK - Në orën 11:01 një pjesë e territorit të Republikës së Shqipërisë u lëkund nga një tërmet me fuqi 6

ballë. Epiqendra ishte Gjiri i Lalzit, në zonën e Durrësit. Rexhep Koçi, përgjegjës i Departamentit të Sizmiologjisë,

tha se tërmeti ka qenë me magnitudë 5,1 dhe me thellësi 18 km dhe u ndje fort në Tiranë. Në orët e para nuk janë raportuar

dëme serioze, por më shumë panik. Pas goditjes së parë, lëkundjet kanë vijuar edhe për disa orë.



Asociacioni pritet ta vështirësojë fazën finale të dialogut

Njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë bërë me dije se lënia e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe për fazën finale të dialogut do të ishte e gabueshme. Drejtori ekzekutiv i Grupit për Hulumtim të Politikave në Ballkan, Naim Rashiti dhe ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedimet me Serbinë, Edita Tahri, kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se kjo temë e pambyllur do të paraqesë rrezik për Kosovën dhe do ta vështirësojë fazën përfundimtare të procesit të dialogut. Ndërsa shefi i delegacionit të Kosovës për dialog teknik, Avni Arifi, ka thënë se në asnjë rrethanë nuk do të lejohet që statuti i Asociacionit të jetë në kundërshtim me ligjet e Kosovës



**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 KORRIK - Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës janë të bindur se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të themelohet në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Ndërsa njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se lënia e kësaj çështje për fazën finale të dialogut do ta vështirësojë këtë fazë, duke i lejuar Serbisë mundësinë për kërkesa shtesë. Shefi i delegacionit të Kosovës për dialog teknik, Avni Arifi, ka treguar për "Epokën e re" se tashmë grupi menaxherial ka filluar draftimin e statutit, por Qeveria ende nuk ka marrë asnjë draft të këtij statutit. Sipas tij, Qeveria deri më tani ka marrë vetëm transkriptimet apo procesverbalet e takimeve që ky grup menaxherial i ka pasur me disa grupe të interesit. "Është një proces më i komplikuar. Më 8 prill është riaktivizuar grupi menaxherial dhe është çështje kohësh kur ata do ta prezantojnë draftin e parë. Nuk ka asnjë ngecje. Arsyeja se a do të ketë ngecje apo jo varet nga ajo se çfarë ka draftuar grupi menaxherial. Nëse ekipi menaxherial

ka draftuar një statut që është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës atëherë është çështje jave derisa të fillojë implementimi i tij. Nëse jo, atëherë do të kemi telashe, sepse mund të përsëritet situata e vitit 2015, ku në 22 raste kishte shkelje kushtetuese dhe në raste të tilla gjithçka kthehet në pikën zero", ka thënë Arifi. Ai ka deklaruar se në asnjë rrethanë nuk do të lejohet që statuti i Asociacionit të jetë në kundërshtim me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës. "Askush nuk ka të drejtë të dalë përtej Kushtetutës së Republikës së Kosovës në këtë proces si dhe askush nuk ka mandat të nënshkruajë diçka që është në kundërshtim me Kushtetutën", është shprehur Arifi.

Ndryshe nga zyrtarët qeveritarë, njohësit e këtij procesi mendojnë se Kosova ka gabuar që deri më tani nuk e ka mbyllur çështjen e marrëveshjes së Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Sipas tyre, në këtë mënyrë do t'i jepet mundësi Serbisë për kërkesa shtesë rreth Asociacionit. Drejtori ekzekutiv i Grupit për Hulumtim të Politikave në Ballkan, Naim Rashiti, ka thënë për gazetën se kjo çështje do ta vështirësojë fazën finale të dia-

logut. "Palët kanë nënshkruar marrëveshjen në vitin 2013 dhe janë të obliguar të punojnë në zbatimin e saj. Unë e shoh të pamundur zbatimin e marrëveshjes në pikun e negociatave më të vështira të mundshme. Politikisht Kosova po dëshiron që asociacionin ta shesë si pjesë të marrëveshjes finale, ndërsa Serbia nuk dëshiron zbatimin e kësaj marrëveshje, sepse për marrëveshjen finale shpreson një asociacion krejt tjetër. Ky është ndoshta një dështim i pjesshëm i Kosovës që ka lejuar që asociacioni të mbetet pjesë e negociatave finale, por edhe i BE-së që ka lejuar të mos ndodhë zbatimi i marrëveshjes. Po të kishim zbatim të plotë të marrëveshjeve të deritashme, pozicioni i Serbisë në këto negociata do të ishte më i dobët. Çështjet e moszbatimit të marrëveshjeve do të jenë pjesë e marrëveshjes gjithëpërfshirëse, të cilat do ta vështirësojnë atë. Këtu do të përfshihet ndoshta edhe rinegociimi i marrëveshjeve që janë bërë deri më tani", ka thënë Rashiti. Sipas tij, Kosova duhet të jetë kreative në përgjigjen e

kërkesave të Serbisë për këtë çështje. "Për shembull, me rastin e kërkesave për status special të serbëve në veri, apo autonomi, do të përfshihen energjetika dhe telekomi si pjesë të marrëveshjes. Këtu është ajo nevoja e kreativitetit të Kosovës që duhet të kemi përgjigje për çdo gjë. Në këtë drejtim duhet të kemi një llokim buxhetor dhe politik të institucioneve që të kërkohet edhe mbështetje ndërkombëtare për këtë proces. Ne duhet të llojmë tek shtetet anëtare të BE-së edhe për dialog me Serbinë, jo vetëm për liberalizim të vizave", ka thënë ai.

Me herët edhe ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedimet me Serbinë, Edita Tahri, ka ftuar institucionet e Kosovës që sa më shpejt ta formojnë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Ajo ka deklaruar se lënia e formimit të Asociacionit për fazën finale të dialogut është e rrezikshme për Kosovën. "Derisa bëhet hartimi i statutit të Asociacionit, Serbia duhet t'i plotësojë obligimet e veta, duke zbatuar marrëveshjen për energjinë, ta lejojë hapjen e urës

së Ibrit, t'i kthejë regjistrat kadastralë, ta bëjë njohjen e diplomave dhe t'i kryejë obligimet e tjera që i takojnë. Ndërsa Kosova duhet ta përshpejtojë zbatimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në mënyrë që të mos lejohet që kjo çështje të shkojë në pakon e marrëveshjes finale. Marrëveshja për Asociacionin, të cilën ne e kemi arritur në Bruksel, nuk i jep kompetenca ekzekutive Asociacionit. Nëse vonohet Asociacioni dhe hynë në pakon e bisedimeve përfundimtare, ka rrezik që Serbia mund të bëjë kërkesa devijuese jashtë marrëveshjes", ka thënë Tahiri.

Marrëveshja për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe është arritur në vëren e vitin 2015 në Bruksel. Pas një kundërshtimi të fuqishëm të opozitës për këtë marrëveshje e kishte dhënë mendimin edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës, e cila pati konstatuar se kjo marrëveshje nuk është në frymën kushtetuese. Ndërsa këtë vit, më 8 prill, është riaktivizuar grupi menaxherial i cili do ta hartojë statutin e këtij asociacioni.



Haxhiu: Vendimet e paligjshme të Qeverisë për ngritjen e pagave kanë ngjallur reagime

PRISHTINË, 4 KORRIK (ER) - Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, ka thënë se rreth 2 000 punëtorë që punojnë në sistemin e drejtësisë janë në grevë për shkak të pagave të vogla. Ajo ka thënë se kërkesa e tyre për rritje të pagave është e drejtë dhe legjitime. "Rreth 2 000 punëtorë (shërbyes civilë) që punojnë në sistemin e drejtësisë janë në grevë për shkak të pagave të vogla.

Kërkesa e tyre është ngritja e pagave dhe rregullimi i statusit të tyre. Vendimet e paligjshme të Qeverisë Haradinaj për ngritjen e pagave për vete në 100 për qind, kanë ngjallur shumë reagime dhe pakënaqësi tek punëtorët dhe jo vetëm tek administrata gjyqësore", ka shkruar Haxhiu në llogarinë e vet në "Facebook". Ajo ka shtuar se kjo kërkesë e punëtorëve është e drejtë dhe shumë legjitime. "Është e

papranueshme që shërbyesit civilë në sistemin e drejtësisë (të cilat janë të mbingarkuar me punë) të marrin 300 deri në 350 pagë, ashtu siç është e papranueshme që kirurgu të paguhet vetëm 600 euro, infermieri vetëm 340, mësuesi vetëm 450 euro, apo zjarrfikësi 350 euro, ashtu siç është e papranueshme që shteti të mos ofrojë mirëqenie për kategoritë sociale", ka thënë Haxhiu.

Flet për "Epokën e re", Bekim Jashari

Po e kthejmë besimin e

- Deri më tani punët kanë ecur mirë dhe jemi në drejtim të realizimit të qeverisjes transparente dhe llogaridhënëse

Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, është shprehur i kënaqur me qeverisjen e deritanishme në këtë komunë, por ka thënë se ende ka shumë për t'u bërë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se është duke punuar në mënyrë transparente duke dhënë llogari para qytetarëve për çdo vendim. Pavarësisht prej sfidave, ai ka premtuar se do ta vazhdojë realizimin e projekteve që përmirësojnë jetën e qytetarëve. Jashari ka treguar se është duke u punuar maksimalisht për ta kthyer besimin e qytetarëve në Komunën e Skenderajt. Ai ka bërë me dije se deri më tani punët kanë ecur mirë dhe janë në drejtim të realizimit të qeverisjes transparente dhe llogaridhënëse. Jashari ka thënë se Komuna e Skenderajt ka bashkëpunim të mirë me të gjitha institucionet e nivelit qendror

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 4 KORRIK - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë të mërkurën se është duke qeverisur në mënyrë transparente dhe llogaridhënëse. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se është duke u punuar maksimalisht për ta kthyer besimin e qytetarëve në Komunën e Skenderajt. "Është herët të flitet për këtë, por po punojmë pastër dhe me transparencë, po japim llogari para qytetarit për çdo vendim dhe kjo më bën të ndihem mirë. Kemi filluar mirë, po zbatohen ligjet, po bëhen veprime ligjore dhe punë të mëdha, por gjithmonë ka vend për më shumë punë. Unë nuk kënaqem derisa t'i realizojmë projektet që përmirësojnë jetën e qytetarëve të Skenderajt tonë. Qeverisja lokale është sfidë dhe jemi të vetëdijshëm për këtë, por sigurt po ecim drejt kthimit të besimit të qytetarëve në institucionin e tyre në Komunën e Skenderajt", është shprehur Jashari.

Ai ka bërë me dije se Komuna e

Skenderajt ka bashkëpunim të mirë me të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe, sipas Jasharit, deri më tani janë nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me ministri të ndryshme. "Komuna e Skenderajt ka bashkëpunim të mirë me nivelin qendror. Si kryetar kam raporte të shkëlqyera me kryeministrin Haradinaj, i cili është duke u munduar të na mbështesë brenda hapësirave që ka. Gjithashtu, raporte të mira kam me të gjitha institucionet e nivelit qendror", ka theksuar ai. Kryetari i Skenderajt ka folur edhe për gjendjen në të cilën ndodhet Kompleksi Memorial "Adem Jashari", duke thënë se kulla dhe shtëpitë po shkatërrohen në mungesë të menaxhimit të mirë nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale.

"Epoka e re": Z. Jashari, të mërkurën jeni takuar me ministrin e Diasporës, z. Dardan Gashi, me të cilin jeni pajtuar që më 1 dhe 2 gusht manifestimi i Ditës së Diasporës të mbahet në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Mund të na

tregoni se cilat do të jenë aktivitetet që do të realizohen gjatë këtyre ditëve?

Jashari: Në takimin e së mërkurës me ministrin e Diasporës, Dardan Gashi, jemi pajtuar që kjo ngjarje të mbahet në Skenderaj, ku do të përfshihet diaspora gjithëshqiptare. Në këtë aktivitet jemi bashkë me ministrinë përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ministrinë përkatëse të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Parimisht u pajtuam të bëhet ky organizim me një këshill organizativ në mes të Komunës së Skenderajt dhe Ministrisë së Diasporës. Këshilli do ta fillojë punën në javën e ardhshme ku do ta finalizojë agjendën e ministrisë për shënimin e kësaj dite me aktivitetet e parapara nga Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport në komunën tonë. Për shkak se kompleksi memorial "Adem Jashari" në Prekaz menaxhohet nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale dhe janë bërë shumë investime, pas fjalimeve pjesa artistike do të zhvendoset në sheshin e qytetit në Skenderaj. Prandaj, për të gjitha detajet, për datat dhe aktivitetet do të njoftoheni me kohë pasi të jetë harmonizuar dhe finalizuar agjenda me aktivitetet e parapara për shënimin e ditëve të mërgatës.

"Epoka e re": Kryetar, sa jeni i kënaqur me qeverisjen e deritanishme në Komunën e Skenderajt?

Jashari: Është herët të flitet për këtë, por po punojmë pastër dhe me transparencë, po japim llogari para qytetarit për çdo vendim dhe kjo më bën të ndihem mirë. Kemi filluar mirë, po zbatohen ligjet, po bëhen veprime ligjore dhe punë të mëdha, por gjithmonë ka vend për më shumë punë. Unë nuk kënaqem derisa t'i realizojmë projektet që përmirësojnë jetën e qytetarëve të Skenderajt tonë. Qeverisja lokale është sfidë dhe jemi të vetëdijshëm për këtë, por sigurt po ecim drejt kthimit të besimit të qytetarëve në institucionin



e tyre, në Komunën e Skenderajt.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh se jeni kryetar i pavarur, sa po keni vështirësi ta realizoni programin qeverisës? Keni arritur t'i tejkaloni mospajtimet me PDK-në që keni pasur në fillim të mandatit tuaj gjatë punës së Kuvendit Komunal të Skenderajt?

Jashari: Unë si kryetar i pavarur prej që kam filluar qeverisjen së bashku me stafin jemi duke u angazhuar t'i realizojmë prioritetet tona dhe në këtë mënyrë të realizohet sa më mirë programi ynë qeverisës. Deri më tani punët kanë ecur mirë dhe jemi në drejtim të realizimit të qeverisjes transparente dhe llogaridhënëse gjë që ka qenë edhe zotimi ynë. Po ashtu, jemi duke bashkëpunuar në mënyrë të duhur me anëtarët e kuvendit komunal dhe unë të gjithë këta anëtarë i shoh të njëjtë, kam kontakte dhe partneritet me secilin prej tyre për të mirën e qytetarëve. Do të thotë,

nuk më bëjnë përshtypje se nga cilat parti politike ata vijnë. Qëllimi im është që të sjellim gjëra të mira në kuvend, të cilat janë në interes të qytetarëve tanë dhe ato gjëra së bashku t'i shtyjmë para.

"Epoka e re": Gjatë kësaj periudhe sa keni arritur t'i realizoni kërkesat dhe pritjet e qytetarëve?

Jashari: Ne e dimë se kërkesat e qytetarëve janë relativisht të mëdha në krahasim me buxhetin që ka komuna, mirëpo ne jemi të përkushtuar që aty ku është më e nevojshme të fillohet së pari dhe kështu duke alokuar investimet sipas rëndësisë dhe kërkesave që janë në prioritet. Duke krijuar kështu një frymë ekuilibruese dhe duke i bindur qytetarët se investimet me të vërtetë janë duke ndodhur aty ku është më se e nevojshme, pastaj duke vazhduar tutje. Gjithashtu, po bëjmë të pamundurën t'i ndërmarim të gjitha veprimet e nevojshme që ta



qytetarëve në Skenderaj



përmirësojmë jetën e tyre duke ofruar shërbime cilësore në të gjitha sferat e qeverisjes komunale.

"Epoka e re": Cilat janë raportet në mes të Komunës së Skenderajt dhe Qeverisë në nivelin qendror? E keni mbështetjen e Qeverisë së udhëhequr nga Haradinaj për realizimin e projekteve që janë në interes të Skenderajt?

Jashari: Komuna e Skenderajt ka bashkëpunim të mirë me nivelin qendror. Po ashtu, si kryetar kam raporte të shkëlqyera me kryeministrin Haradinaj, i cili është duke u munduar të na mbështesë brenda hapësirave që ka. Raporte të mira kam me të gjitha institucionet e nivelit qendror. Deri më tani kemi nënshkruar disa memorandume mirëkuptimi për realizimin e projekteve në komunën tonë me ministrinë përkatëse. Pra, kemi nënshkruar memorandum me Ministrinë e Ambientit, Infrastrukturës, Kulturës dhe jemi

duke nënshkruar edhe me Ministrinë e Arsimit si dhe me ministrinë e tjera.

"Epoka e re": Tashmë është proceduar për Kuvend miratimi i një ligji të veçantë me të cilin do të trajtohet Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Prisni që Kuvendi sa më shpejt ta aprovojë këtë ligj në mënyrë që kompleksi të shpëtojë nga shembja?

Jashari: Kuvendi ka për detyrë nxjerrjen e ligjeve të mira dhe lehtësisht të zbatueshme. Edhe ligji i vjetër nuk e ka ndaluar trajtimin e kompleksit, restaurimin dhe konservimin e objekteve në kompleks. Kulla dhe shtëpitë po shkatërrohen sepse nuk është funksionalizuar me kapacitetet e nevojshme Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale në mënyrë që ta menaxhojë kompleksin përkujtimor "Adem Jashari" në Prekaz. Edhe kështu siç ka qenë kjo agjenci nuk ka qenë në

nivelin e dëshiruar në kuptimin funksional, nuk është menaxhuar si duhet. Ligji ka mangësi dhe institucionet përkatëse duhet të fokusohen sidomos tek elementet përmbajtëse juridike që ato të jenë të saktësuar, të mos ketë shumëkuptimësi dhe të jetë lehtësisht i interpretueshëm, duke paraparë të gjitha rrethanat e nevojshme që e rregullojnë hapësirën brenda kompleksit dhe sjelljet e personave juridikë dhe fizikë brenda atyre hapësirave. Komisionet parlamentare dhe sponsoruesi i ligjit do të duhej t'i trajtonin të gjitha kërkesat e palëve të interesit në kompleks dhe nëse është e nevojshme, të dalë edhe në seancat e dëgjimit publik ku njerëzit e profileve të ndryshme do të kishin mundësi për t'i dhënë idetë dhe format e ndryshme organizative të cilat hartuesi do t'i harmonizonte dhe t'i saktësonte në aspektin juridik brenda dispozitave dhe neneve të këtij ligji.

Bie numri i aksidenteve në trafik

Policia e Kosovës ka njoftuar se në gjashtëmuorin e parë të këtij viti kanë ndodhur 7 003 aksidente në trafik, kurse për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kishin ndodhur 8 073. Por, policia ka bërë me dije se janë rritur të hyrat nga gjobat e trafikut për periudhën janar - qershor 2018 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017

**EPOKA
ERE**

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 4 KORRIK - Pas fillimit të zbatimit të nenit 43 të Ligjit për Automjete, Nr. 05/L-132 dhe pas rritjes së masave të sigurisë në komunikacion nga ana e Policisë së Kosovës, në Republikën e Kosovës ka filluar të bie numri i aksidenteve në trafik. Sipas raportit të Policisë së Kosovës, krahasuar me gjashtëmuorin e vitit të kaluar, numri total i aksidenteve në gjashtëmuorin e parë të këtij viti ka rënë për 13.25 për qind. Nga 8 073 aksidente në trafik që kanë ndodhur në periudhën janar - qershor 2017, sivjet kanë ndodhur 7003 aksidente, që do të thotë 1 070 aksidente më pak. Po qe se bëjmë një krahasim të aksidenteve në muajin qershor 2017, në të cilin kanë ndodhur 15 aksidente me vdekje të personave, në qershor të këtij viti kanë ndodhur pesë aksi-

dente me fatalitet. Gjithashtu, është bërë rritja e të hyrave nga gjobat e trafikut për periudhën janar-qershor 2018 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Nga shuma e inkasuar prej 1 milion e 514 mijë eurosh, këtë vit janë inkasuar 2 milionë e 860 mijë euro. Ministria e Punëve të Brendshme fton të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës t'i respektojnë rregullat e komunikacionit, sidomos gjatë sezonit veror kur pritet të rritet numri i pjesëmarrësve në komunikacion rrugor. Që nga muaji i kaluar Ministria e Punëve të Brendshme ka filluar zbatimin e nenit 43 të Ligjit për Automjete, Nr. 05/L-132, i cili kërkon që: "Pronari i mjetit nuk mund ta bëjë regjistrimin apo vazhdimin e regjistrimit të mjetit me veprim motorik, as ndërrimin e pronarit pa e bërë shlyerjen e gjobave për kundërvajtje në trafikun rrugor".



Apostolova kërkon që ngritja e cilësisë në arsim të nisë nga reformat në MASHT

EPOKA E RE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 4 KORRIK - Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataly Apostolova, gjatë takimit që ka pasur të mërkurën me anëtarët e Komisionit Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, ka thënë se BE-ja e ka prioritet kryesor arsimin në Kosovë. Ajo ka thënë se për këtë sektor do ta rrisë fondin nga 12 deri në 15 milionë euro. "Çështja e arsimit duhet ta ketë financimin e duhur dhe BE-ja ka ndarë fonde për këtë. Ne synojmë ta rrisim këtë fond nga 12 deri në 15 milionë euro, pra me fondet IPA 2015-2017", ka thënë Apostolova.

Ajo ka shtuar se reformat në sistemin e arsimit duhet të fillojnë sa më shpejt, duke filluar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. "Ne kemi bërë një analizë të thellë nga ana e GIZ-it dhe kjo na ka sjellë konkludimin se duhet të bëhen reforma rreth arsimit. Ky proces do të jetë afatgjatë dhe do të ketë një kosto. Duhet të fillohet me MASHT-in. Është me rëndësi që së pari t'i kemi ndryshimet në ministri. Dua t'ju njoftoj se dje kam pasur një takim të rëndësishëm me gjithë stafin e ministrisë. E kam kuptuar për



Bashkimi Evropian (BE) është i vendosur të bëjë reforma për një arsim cilësor në Kosovë dhe nuk e ka ndërmend të dorëzohet sa i përket këtij procesi. Këtë e ka bërë me dije përfaqësuesja e BE-së në Kosovë, Natalyia Apostolova, gjatë takimit në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, ku u diskutua përkrahja e BE-së për ngritjen e cilësisë në arsim

herë të parë se sa e vështirë do të jetë reforma. Ka rezistencë të fortë sa i përket organogramit të ri. Megjithatë, dua t'ju siguroj se kjo reformë është shumë me rëndësi për ne dhe nuk do të heqim dorë", ka deklaruar

Apostolova. Ajo ka kërkuar nga anëtarët e Komisionit Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi që ta rishikojnë Projektligjin për arsimtarët e

viteve '90. "Kërkoj nga ju ta rishikoni këtë ligj, sepse ky ligj do ta dëmtojë buxhetin e shtetit. Nëse të gjitha paratë shpenzohen vetëm në një sektor atëherë çfarë do të ndodhë me sektorët e tjerë", është shprehur

Apostolova.

Kryetari i Komisionit për Arsim, Sami Kurteshi, ka deklaruar se si komision i kanë përfunduar katër ligje, njëri prej të cilëve është edhe Ligji për Arsimin dhe ka shtuar se tash ato duhet të shkojnë në Kuvend dhe të aprovohen. "Komisioni ka vizituar Ministrinë e Arsimit, shkolla e universitete. Planifikojmë të kemi takim me të gjitha universitetet publike, në mënyrë që ta ndihmojë rritjen e cilësisë së arsimit në vend", ka thënë ai.

Kurteshi ka shtuar se rezoluta e miratuar në vitin 2017 që do t'i mundësonte arsimin të jetë prioritet kombëtar ka mbetur dokument në sirtar të Kuvendit. "Arsimi në Kosovë nuk do të ecë përpara me fushata, por vetëm nëse organizohemi më mirë, nëse punojmë në mënyrë konsistente dhe t'i lidhim të rinjtë me tregun e punës, të mos jenë të pashpresë dhe të mos shqetësohen vetëm për liberalizimin e vizave, pasi ajo nuk është zgjidhje për gjeneratat tona", ka thënë Kurteshi. Kurse deputetja e AAK-së, Teuta Haxhiu, ka thënë se pa e depolitizuar arsimin nuk pritet të ketë rezultate pozitive në arsim. Deputeti i PDK-së, Nezir Çoçaj, ka kërkuar më shumë investime në arsimin parashkollor dhe për fëmijët me nevojë të veçanta.

Ekipi i mjekëve nga Australia dhe Kosova po operojnë 27 fëmijë

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 KORRIK - Nga data 30 qershor deri më 7 korrik në Klinikën e Kirurgjisë së Fëmijëve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) është duke qëndruar një ekip i mjekëve nga Australia. Në vazhden e vizitës së radhës nga profesorët nga Australia dhe ekipi i mjekëve nga Kirurgjia e Fëmijëve, në udhëheqjen e prof. dr. Nexhmi Hysenit, janë bërë 49 vizita të fëmijëve me anomalji kongjeni-

tale shumë të komplikuar. Pas vizitave mjekësore, janë përzgjedhur për intervenim kirurgjik 7 fëmijë, deri tani janë kryer 13 operacione komplekse, përderisa deri të premtën pritet të kryhen edhe 14 operacione.

Ekipi i mjekëve po punon gjatë gjithë ditës, deri në orët e vona të natës, në mënyrë që të gjithë fëmijët që kanë nevojë për operacion të kenë mundësi të marrin këtë shërbim. "Duke iu falënderuar prof. Pady Dewanit dhe ekipit vendor, organizatës 'Kind Cuts for

Kids' dhe Komunitetit Shqiptar në Melburn të Australisë, është shpëtuar buxheti i dedikuar për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore në vlerë 530 000 euro", është bërë me dije në komunikatën e QKUK-së.

Bashkëpunimi i ngushtë i këtij lloji me profesorë nga Australia ka nisur nga viti 2010 dhe ka dhënë rezultate të shkëlqyeshme post-operative duke pasur një rëndësi të madhe edhe për edukimin profesional të vazhdueshëm të mjekëve.



Hoxhaj: Njohje e ndërsjellët, në fund të dialogut Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 4 KORRIK (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka takuar të mërkurën të gjithë ambasadorët e shteteve të Bashkimit Evropian, me të cilët kanë diskutuar në lidhje me fazën finale të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të ndër-

mjetësuar nga BE-ja. Hoxhaj ka thënë se për Kosovën është e rëndësishme që kjo të mos jetë fazë e re, por fazë finale e dialogut. Ai theksuar se arritja e një marrëveshje obligative ligjore është po aq e rëndësishme sa edhe implementimi i plotë i saj.

Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka deklaruar para ambasadorëve të BE-së se marrëveshja obligative ligjore që duhet të arrihet në mes të Kosovës dhe Serbisë në përmbyllje të dialogut, për Kosovën ka një emër dhe ajo është njohje e ndërsjellët. "Biseduam

për zhvillimet më të fundit politike, dialogun Kosovë - Serbi dhe agjendën evropiane me shefat e misioneve të shteteve anëtare të BE-së. Arritja e një marrëveshje obligative ligjore është po aq e rëndësishme sa implementimi i plotë i saj, e kjo për Kosovën




do të thotë njohje e ndërsjellët", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Twitter".

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar rezultatet e sondazhit në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi dhe për zgjedhjet e parakohshme parlamentare

Sondazhi: LDK-ja para PDK-së, Nisma ka rritje

Nga sondazhi i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), i cili është publikuar të mërkurën, ndër disa pyetje janë edhe rezultatet për subjektet politike nëse zgjedhjet do të mbaheshin tani. 30.8 për qind e të anketuarve kanë thënë se do të votonin për LDK-në, 23 për qind për PDK-në, 21.2 për qind për LV-në, 10.4 për qind për AAK-në, 6.3 për qind për Nismën, 2.4 për qind për PSD-në, 2 për qind për Listën Serbe dhe 4.1 për qind të tjera



Faton DERMAKU

PRISHTINË, 4 KORRIK - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të mërkurën konferencë për media gjatë së cilës janë shpalosur rezultatet e sondazhit me opinionin publik lidhur me fazën përfundimtare të dialogut Kosovë - Serbi dhe çështjet aktuale që janë trajtuar së fundi nga partitë politike si zgjedhjet e parakohshme. Me këtë rast, Violeta Haxholli nga KDI ka bërë me dije se qytetarët janë pyetur nëse do të votonin në rast se zgjedhjet parlamentare do të mbaheshin të dielën e ardhshme. 45.3 për

qind kanë thënë se do të votonin definitivisht, 29.8 për qind ndoshta do të votonin, 6.9 për qind me gjasë nuk do të votonin, 8.8 për qind definitivisht nuk do të votonin, 3.2 për qind kanë deklaruar se nuk e dinë dhe 6.1 për qind kanë refuzuar të kthejnë përgjigje. Kurse të pyetur se për cilën parti politike do të votonin, vetëm nga votat e deklaruara: 30.8 për qind e të anketuarve kanë thënë se do të votonin për Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), 23 për qind për Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), 21.2 për qind për Lëvizjen Vetëvendosje, 10.4 për qind për Aleancën për

Ardhmërinë e Kosovës (AAK), 6.3 për qind për Nisma Socialdemokrate, 2.4 për qind për Partinë Socialdemokrate, 2 për qind për Listën Serbe dhe

4.1 për qind të tjera. Janë 11.6 për qind e të anketuarve që kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje.


44 për qind e qytetarëve thonë se Thaçi duhet ta udhëheqë dialogun me Serbinë

Sa i përket pyetjes drejtuar qytetarëve të Kosovës se çfarë presin ata që të përmbajë marrëveshja përfundimtare në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi, 61 për qind e tyre kanë deklaruar se presin që kjo marrëveshje ta përmbajë njohjen e shtetit të Kosovës nga Serbia, 56 për qind anëtarësimin e Kosovës në OKB, 22 për qind për shkëmbimin e territoreve midis Kosovës dhe Serbisë, 25 për qind autonomi të zgjeruar për serbët e Kosovës. Në vazhdim qytetarët janë pyetur mbi pranushmërinë e rezultateve nga kjo marrëveshje. Bazuar në sondazh, Violeta Haxholli nga KDI-ja ka thënë se 97 për qind e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se do të pranonin që rezultati i bised-

imeve të fazës finale të jetë njohja e shtetit të Kosovës nga Serbia. Ndërkaq të gjithë qytetarët nga komuniteti shqiptar e pranojnë këtë opsion, kurse 91 për qind të komunitetit serb kanë deklaruar se nuk do t'pranonin njohjen e shtetit të Kosovës nga Serbia.

Kurse Jeta Krasniqi nga KDI-ja ka potencuar se në pyetjen se kush duhet të udhëheqë grupin negociator të Kosovës në bisedimet me Serbinë, 44 për qind e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se duhet ta udhëheqë presidenti i Kosovës, 31 për qind e tyre mendojnë se duhet ta udhëheqin liderë nga opozita dhe 25 për qind janë të mendimit se grupin negociator në bisedime me Serbinë duhet ta udhëheqë kryeministri i Kosovës.

Në pyetjen se a mendojnë qytetarët e Kosovës se marrëveshja përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë do ta largojë përfundimisht ndikimin e Serbisë nga Kosova, Krasniqi ka bërë me dije se 48 për qind e të anketuarve mendojnë se kjo nuk do të ndodhë me marrëveshjen përfundimtare.



Haradinaj: Të gjithë duhet të jemi të përfshirë në dialog me Serbinë

PRISHTINË, 4 KORRIK (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka kërkuar përfshirjen e të gjithëve në fazën finale të dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se janë duke u përballur me

tema të cilat nuk janë zgjidhur që disa vjet. "Si Qeveri po përballlemi më shumë tema që nuk kanë marrë zgjidhje me vite. Sot kemi 'Trepçën' me statut, kemi energji stabile dhe po e

arrijmë pavarësinë energjetike, po i trajtojmë kërkesat dhe problemet e komunave, të anashkaluar për një kohë të gjatë. Të gjithë duhet të jemi të përfshirë në dialog me Serbinë

në këtë fazë finale. Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret dhe tani liberalizimi i vizave është vullnet politik", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Gërxhaliu ndan mirënjohje për brendin 'Shell' në Kosovë

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 KORRIK - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ka ndarë të mërkurën mirënjohje për kompaninë botërore të derivateve "Royal Dutch Shell", për kontributin në zhvillimin ekonomik të vendit, përmirësimin e imazhit dhe promovimin e Kosovës përballë investitorëve të huaj.

"Shell" ka nënshkruar para pak muajsh marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë kosovare të derivateve "Al Petrol" për hapjen e pikave të saj të shitjes së derivateve në Kosovë.

Gërxhaliu e ka vlerësuar praninë e brendit botëror "Shell" të një rëndësie të veçantë për ekonominë e Kosovës dhe për imazhin e saj në arenën ndërkombëtare.

Kurse menaxheri i kompanisë "Shell" për Evropën Juglindore, Vim Riegman, ka thënë se janë të nderuar dhe krenarë që, përpos në 80 shtete të botës, shesin derivatet e tyre kualitative edhe në Kosovë. Ai ka përmendur edhe bashkëpunimin e tyre me Ferrarin. Riegman ka theksuar se prania e tyre këtu i ndihmon zhvillimit të ekonomisë së Kosovës, kurse bashkëpunimin me "Al Petrol"-in e ka vlerësuar të nivelit të duhur.

Pronari i "Al Petrol"-it, Latif Kryeziu, ka thënë se me ardhjen e "Shell"-it, Kosova i ka hequr brengat për furnizim me derivate cilësore. Në këtë drejtim ai ka thënë se janë hapur dyert për investitorët e tjerë. Kryeziu ka pohuar se ardhja e "Shell"-it në Kosovë është garanci për brendet e tjera botërore që të investojnë në vendin tonë.

Të gjitha pikat e "Al Petrol"-it janë riemërtuar "Shell".



Hamza në samitin e Vjenës flet për progresin e arritur në sektorin e ekonomisë



VJENË, 4 KORRIK (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka marrë pjesë në samitin e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor i cili është mbajtur në Vjenë të Austrisë. Ky samit vjen si vazhdimësi e procesit të Berlinit dhe ka për qëllim t'i diskutojë zhvillimet ekonomike të vendeve të rajonit me qëllim të bashkëpunimit dhe të lehtësimit në qasjen në financa për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Njëkohësisht, ky takim i parapraktimit të kryeministrave të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor që do të mbahet javën e ardhshme në Londër.

Në fjalën e tij, ministri Hamza ka folur për hapat që Qeveria e Kosovës i ka marrë për ta ruajtur stabilitetin makro-fiskal dhe financiar dhe për ta përmirësuar ambientin e të bërit biznes, ku si rezultat i këtyre veprimtarive në vitin e kaluar Kosova është ran-

guar si një ndër vendet top reformatore në raportin e të bërit Biznes të Bankës Botërore.

Më tej, ai ka theksuar sfidat kryesore me të cilat po ballafaqohet sektori privat për të pasur qasje në financa dhe në këtë kuadër ka ftuar të gjitha institucionet financiare ndërkombëtare të ofrojnë mbështetje dhe të ofrojnë produkte të reja financiare për të cilat kanë nevojë bizneset në Kosovë.

Në kuadër të diskutimeve lidhur me zhvillimet në fushën e ekonomisë digjitale, ministri Hamza ka përmendur hapat që kanë ndërmarrë institucionet e Kosovës për t'i mbështetur të gjitha nismat që janë në favor të shtrirjes së formave të veprimtarive ekonomike digjitale në Kosovë.

Ky takim është organizuar nga Britania e Madhe në bashkëpunim me Austrinë dhe

në të kanë marrë pjesë ministrat e fushave ekonomike të vendeve të rajonit dhe të disa vendeve të Bashkimit Evropian si dhe komisionari evropian Johannes Hahn. Në këtë samit pjesëmarrësit u pajtuan për progresin e arritur për zbatimin e Planit Shumëvjeçar të Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale, në kuadër të katër fushave të këtij plani: në tregti, investime, mobilitet dhe integrim digjital.

Lluka: Nga 5.5 milionë euro, vlera e shpronësimeve u rrit 27 milionë euro



Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë se në korrik të vitit 2013 ishte marrë vendim që në fshatin Hade dhe Shipitull të Obiliqit të mos ndërtohej asnjë shtëpi. Sipas tij, nga ajo kohë kur për shpronësim janë dashur 5.5 milionë euro në saje të ndërtimeve pa leje, vlera e shpronësimit tani ka arritur shifrën 27 milionë euro

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 KORRIK - Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, ka mbajtur të mërkurën mbledhje, në të cilën është diskutuar për vendimin e Qeverisë rreth themelimit të grupit teknik me qëllim të propozimit të zhvillimit të Minierës së Re të Korporatës Energjetike të Kosovës.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë se nuk

ka buxhet për shpronësimin në fshatin Hade të Obiliqit. Sipas tij, rasti i Shipitullës ishte më ndryshe me një intervenim urgjent për shkak të krizës energjetike. "Nuk ka buxhet për shpronësim në Hade. Banka Botërore parasheh që çdo shpronësim të bëhet me marrëveshje. Shipitulla ka qenë një rast më unik, sepse ka qenë krizë energjetike. Ka qenë çështje javësh, sepse kemi qenë në kolaps energjetik. Nuk pres që e njëjta të ndodhë edhe në Hade. Ne e kemi krijuar një task-forcë për trajtimin e ndër-

timeve pa leje dhe ajo është në funksion për t'i ndaluar ndërtimet pa leje", ka thënë Lluka. Ai ka bërë me dije se në korrik të vitit 2013 ishte marrë vendim që në këto zona të mos ndërtohej asnjë shtëpi. Sipas tij, nga ajo kohë kur për shpronësim janë dashur 5.5 milionë euro në saje të ndërtimeve pa leje, tani vlera e shpronësimit ka arritur shifrën 27 milionë euro. "Pas korrikut të vitit 2013 të gjitha objektet janë ndërtuar pa leje. Është ortofoto kur shihet që në korrik të vitit 2015 se sa objekte janë ndërtuar. Ministria e Ambientit e ka pasur për obligim t'i ndalë këto ndërtime", ka thënë Lluka.

Ai ka thënë se janë afër gjetjes së zgjidhjes për minierën e thëngjillit në fshatin Hade. "Ne kemi parë sfidën kur kemi qenë para një kolapsi energjetik. Projekti i Kosovës së Re parasheh një minierë të re për

të siguruar thëngjill për 40 vjetët e ardhshëm. KEK-u ka angazhuar një kompani konsulente gjermane, e cila do t'i tregojë anët negative dhe pozitive se ku të marrim thëngjill. Secili opsion që merret shikohet pakti social dhe ambientalist. Ne morëm vendim ta krijojmë një grup profesional dhe të merret vendimi se nga të shkohet. Në kohë afatgjatë, Hada nuk e ka vendin aty, sepse është me thëngjill. Pra, nuk është vend i shëndetshëm për të jetuar aty", është shprehur ai.

Kurse avokati i Popullit, Hilmi Jashari, ka thënë se duhet të gjendet një zgjidhje urgjente për këto zona, pasi në vazhdimësi po shkelen të drejtat e njeriut. "Si avokat i popullit e kemi ngritur një shqetësim për fshatrat Hade dhe Shipitullë. Situata në terren dhe të drejtat e banorëve nuk janë në rregull. E shoh që nuk ka

ndonjë lëvizje në këtë drejtim. Banorët konsiderojnë se kanë mbetur me një oazë. Kjo vonesë nga viti 2004 e deri tash ka ngritur koston e shpronësimit të banorëve. Nëse vazhdon të ketë vonesa të tilla do të ndikojë negativisht në anën ekonomike", ka deklaruar Jashari.

Zëvendësministri i Financave, Mustafë Grainca, ka thënë se janë në pritje të vendimit dhe në përputhje me të do ta japin zgjidhjen më të mirë.

Përfaqësuesi i fshatit Hade, Ragip Grajçevci, ka thënë se rekomandimet e nxjerra nga komisionet përkatëse nuk janë zbatuar asnjëherë. Sipas tij, për Hadën deri tash nuk ka pasur zgjidhje. Ai ka thënë se ndërtimet pa leje janë bërë nga njerëzit që nuk janë banues në këto zona. Sipas tij, këto ndërtime janë bërë për qëllime të përfitimeve materiale.

AKP-ja transferon mbi 42 milionë euro në fondin e Kosovës

PRISHTINË, 4 KORRIK (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka njoftuar se bordi i drejtorëve të kësaj agjencie në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor të këtij viti ka vendosur edhe për transferimin e "Fondeve të mbetura" të likuidimit në vlerë prej 42,159,638.15 eurosh në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës. "Bazuar në ndryshimet e reja ligjore të parapara në nenin 2.6 të Ligjit

nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-80 dhe Ligjin nr. 04/L-115, këto fonde janë bartur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, në një llogari të veçantë në Thesarin e Kosovës. Përveç këtyre fondeve, Agjencia kishte bartur fonde tepriçë edhe më parë në Fondin e

Konsoliduar të Republikës së Kosovës: në korrik të vitit 2012 në vlerë prej 28,9 milionë eurosh dhe në dhjetor të vitit 2015 në vlerë prej 61,3 milionë eurosh", është thënë në njoftimin e AKP-së. Sipas këtij njoftimi, vlera e tërësishme e fondeve të bartura nga Agjencia në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës që nga fillimi i procesit të likuidimit deri më tani ka arritur shumën prej 132.3 milionë eurosh.



Diaspora shqiptare mblidhet në Prekaz më 1 dhe 2 gusht

PRISHTINË, 4 KORRIK (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Dardan Gashi, dhe kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, janë takuar të mërkurën dhe kanë biseduar për manifestimin e Ditës së Diasporës e cila do të mbahet më 1 dhe 2 gusht në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Ata janë pajtuar që gjatë 1 gushtit tradicionalisht të organizohen homazhe te

varrezat e familjes Jashari për bashkatdhetarët, organizim ky i përbashkët në mes të përfaqësuesve të familjes së komandantit Adem Jashari, Komunës së Skenderajt dhe Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike. Në këtë ceremoni do të marrë pjesë edhe ministri i Shtetit për Diasporën nga Shqipëria, Pandeli Majko, si dhe personalitete të tjera nga jeta politike shqiptare në Kosovë, Shqipëri

e Maqedoni.

Ndryshe, 2 gushti në Kosovë është rregulluar me Ligjin mbi diasporën dhe shënon Ditën e Diasporës. Gjatë dy ditëve Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm, organizon aktivitete të shumta dhe, ndër të tjera, ndan çmimet për mërgimtarin e vitit si dhe çmimet për gazetarin/storien e vitit për diasporën.



Aktivizimi i sistemit mbrojtës për vreshtat, i nevojshëm për Rahovecin

Krijimi i Zonës Ekonomike në Komunën e Rahovecit është lajm i mirë për bizneset e kësaj komune për zhvillimin ekonomik, por edhe për të punësuarit. Kështu ka deklaruar të mërkurën kryeministri Ramush Haradinaj gjatë vizitës që u ka bërë disa fshatrave të Komunës së Rahovecit

RAHOVEC, 4 KORRIK (ER) - I shoqëruar nga kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, kryeministri Ramush Haradinaj ka vizituar Zonën Ekonomike mbi Oterushë, e cila, me vendim të Qeverisë, është shpallur zonë e lirë ekonomike, me qëllim që të ndihmojë në zhvillimin ekonomik të kësaj ane përmes ofrimit të lehtësirave për bizneset të cilat veprimtarinë e tyre do ta zhvillojnë në këtë zonë të lirë ekonomike dhe me mundësinë e hapjes së vendeve të reja të punës.

Haradinaj ka vizituar edhe palestrën e sportit në Rahovec për t'i parë nga afër punimet të cilat janë në përfundim e sipër, për ta vazhduar vizitën te vreshtat e dëmtuara nga breshëri në fshatin Fortesë-



Pataqan i Poshtëm si dhe dëmet që i janë shkaktuar nga breshëri fermerit Ismajl Morina nga fshati Gexhë, në rreth 10 hektarë tokë të mbjella, derisa në fund të qëndrimit të tij në Rahovec, kryeministri Haradinaj ka vizituar përroin në mes të fshatrave Krushë e Madhe-Celinë. "Qeveria e vendit do ta përshpejtojë dhënien

e subvencioneve që të paktën t'u dalë në ndihmë fermerëve të kësaj ane. Banorët e Rahovecit do ta kenë përkrahjen e Qeverisë për realizimin e të gjitha projekteve me rëndësi për qytetarët e kësaj komune", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se është e dhimbshme për gjithë këto dëme të shkaktuara nga breshëri dhe vërshimet.

Ai ka thënë se të gjithë duhet të angazhohemi për t'i trajtuar këto probleme dhe këto sfida. Më tutje, kryeministri Haradinaj ka thënë se nga kryetari Latifi ka pranuar një raport i cili përmban të dhënat për dëmet e shkaktuara, që kap shifrën e miliona eurove. "Do t'i shqyrtojmë të gjitha mundësitë e mbrojtjes nga breshëri, sepse

është vështirë t'u dalim përballë dëmeve financiare nëse situata të ngjashme përsëriten nga viti në vit", ka thënë ai.

Ndërsa kryetari Smajl Latifi ka falënderuar kryeministrin dhe Qeverinë për përkrahjen e jashtëzakonshme që i ka dhënë Rahovecit për krijimin e Zonës Ekonomike, pas 17 vjetësh me kërkesa të vazhdueshme.

Nis faza e dytë e dezinfektimit selektiv kundër rriqrave

MALISHEVË, 4 KORRIK (ER) - Në territorin e Komunës së Malishevës ka filluar të realizohet faza e dytë e dezinfektimit selektiv kundër rriqrave. Kjo fushatë e dezinfektimit është duke u zhvilluar në kuadër të masave për parandalimin dhe luftimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), virus i cili bartet përmes rriqrave.

Në ditën e dytë të dezinfektimit këtë fushatë e kanë përcjellë nga

afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha dhe drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Valon Gashi, të cilët janë njoftuar me ecurinë e zhvillimit të kësaj fushate të dezinfektimit. Sipas operatorit dhe mbikëqyrësve, dezinfektimi është duke u realizuar sipas planifikimit. Pas Balincës, dezinfektimi i zonave endemike ka vazhduar të mërkurën në

Mleqan dhe do të vazhdojë edhe në ditët në vijim deri në përfundim të fazës së dytë të kësaj fushate.

Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Valon Gashi, ka bërë me dije se në këtë fazë janë paraparë të dezinfektohen rreth tre mijë hektarë, kryesisht zona të frekuentuara nga qytetarët, ndërsa kjo fushatë e dezinfektimit mundësohet nga buxheti i Komunës së Malishevës.



PROBLEME THEMELORE TË PUNIMEVE STUDIMORE

(Autori është prof. ass. dr. dhe ka ligjëruar për shumë vite lëndët Shkrimi akademik dhe Metodologjia e hulumtimit shkencor)



Hajdin ABAZI

HYRJE

Paul Feyerabend në kryeveprën e tij Kundër metodës (1975) përcjellë mesazhin se kur një mënyrë e të bërit shkencë absorbon kapacitetet e veta atëherë ajo shndërrohet në dogmë dhe kthehet në shtrëngesë që dikton vendnumërim, duke u bërë pengesë për përparim. Në raste të tilla nuk duhet flakur shkencën, por mënyra e të bërit shkencë.

Kështu nuk e kishte shprehur por e kishte bërë, shekuj më parë, René Descartes në shqyrtimin e tij Ligjërime mbi metodën (1639). Ai kishte shquar defektin e bërjes shkencë në kohën e tij dhe përmes një qasjeje kritike, kishte nisur një ndryshim themelor që shkonte në hap me nivelin që kishin arritur shkencat, duke u bërë, kështu, shtytës për të flakur dogmat e vjetra dhe për të pranuar mënyrat e reja të kohës së tij.

Këto tregojnë se nganjëherë mënyra se si bëhet shkencë nuk është e duhura dhe se duhet ndryshuar qasja. Në një gjendje të ngjashme është edhe mënyra se si bëhen te ne punime studimore prej të cilave merren tituj shkencorë dhe pikërisht këtë shqetësim dua ta ngrit këtu. Ajo që do të parashtrij ka të bëjë me aspekte të përgjithshme e jo me raste të veçanta, qasje të cilat thuhet janë shndërruar në dukuri, në trend, në një standard që dominon gjithandej. Ky standard, në këndvështrimin tim, është bërë ngulfatës dhe po pengon ngritjen në një nivel më të lartë të bërjes shkencë, gjë që duhet braktisur ai dhe duhet ngritur më lartë e duhet avancuar.

Janë botuar jo pak libra, kryesisht përkthime, të cilat janë kontribute serioze, nga se sjellin përvoja dhe bëjnë parashtrime të qarta se si duhet bërë një studim. Sidomos dua të theksoj njërin, konkretisht Si shkruhet një punim diplome - shkencat sociale, të Umberto Ecos. Pas botimit në shqip të këtij libri ku shtjellohet shumë qartë se si duhet shkruar një punim studimor - askush nuk mund të arsyetohet se nuk ka ditur se si duhet qasur në një ndërmarrje shkencore.

Dorën në zemër, të gjitha universitetet pa përjashtim kudo në trevat shqiptare, kanë shkruar udhëzues se si të shkruhen dhe ç'duhet të përmbajë një punim studimor (ese, temë bachelor, masteri e doktorate). Ato shprehin adaptimet e standardeve bashkëkohore të bërjes shkencë. E megjithatë, pjesa dërmuese e punimeve të ndryshme studimore këto udhëzime i përfillin vetëm formalisht e jo edhe përmba-

jtësisht. Fjala vjen, nuk mjafton vetëm të figurojë nëntitulli "objektivat" apo "pyetjet studimore", por kërkohet që ato t'i korrespondojnë përmbajtjes dhe sidomos qëllimit. E si është e mundur që përkundër udhëzimeve sipas standardeve bashkëkohore të bërjes shkencë, të ketë ngecje në përmbushjen e tyre përmbajtësore, dhe sidomos metodologjike? Me këtë çështje nuk do të merrem këtu, ndonëse mund të theksoj se në shumicën e rasteve tre faktorë janë që ndikojnë në mënyrë të ndërsjellë: papërvoja e kandidatit, mos përkushtimi i mentorit, dhe prirja për dukje formalisht sipas standardeve. Kam dëgjuar arsytetime të ndryshme, deri te thirrja në emër të lirisë akademike, kreativitetit dhe stilit autorial. Këto janë arsytetime farsë, sepse po të ishin të qëndrueshme, atëherë shtrimi i problemit nga aspekti teorik dhe metodologjik do të ishin në nivelin e duhur. Liria akademike, kreativiteti dhe stili autorial e bëjnë një studim më të veçantë, dhe të realizuar në nivel të lartë shkencor, gjë që në shumicën e rasteve nuk ndodhë me punimet studimore.

Për një konstatim të tillë ka materiale të shumta, aq të shumta sa nuk mund të numërohen madje. Këtu nuk do të merret në shqyrtim tradita e mëhershme, e para dy dekadave, për shkak se ajo gjendje tashmë është tejkaluar. Në kohën kur nuk kishte digitalizim dhe internet, shumica e punimeve studimore kanë mbetur në arkivat universitare, ku mund të gjenden edhe punime doktorate që nuk janë botuar asnjëherë. Më parë, për të arritur deri te një studim i caktuar është dashur kryesisht të shkohet në arkivat e universiteteve, në bibliotekën kombëtare apo në raste të veçanta të kontaktohet autori për t'i kërkuar ndonjë kopje të studimit të tij; tash me një klikim mund të gesh përplot punime studimore të të gjitha nivele, prej atyre themelore e deri te punimet e doktoratës. Kjo mundësi qasjeje në punimet studimore është e shkëlqyeshme, si për të shkëmbyer përvoja, për të mësuar nga njëri-tjetrit, për të njohur mangësitë përcjellëse, ashtu edhe për të shtuar kërkesat që të shkohet drejt standardeve më të larta të punimeve studimore kudo në botën.

Për të bërë shkencë në një mënyrë më afër standardeve me të cilat bëhet shkencë në vendet e perëndimit kam mëtuar të jap kontribut konkret dhjetë vite më parë, më 2008, me botimin nga Kolegji Victory të librit për nevojat studentore "Hyrje në shkrimin akademik" (tekstin e kisha dërguar për shqyrtim, e ai ishte botuar me ngut!). Në atë tekst, si përvojë personale (nga studimet e mia universitare dhe nga studimi i teksteve për shkrime akademike) isha munduar të afirmoja disa standarde themelore se si duhet shkruar punime studimore, të cilat i kisha përmbledhur qartë e

kuptueshëm dhe me një praktikitet të theksuar. Kisha synuar të sillja dhe të kultivoja frymën e shqyrtimit e jo thjesht vetëm të përshkrimi (deskriptivizmit) po te aspekti shqyrtues. Theksin e kisha vënë te struktura tri hallkëshe e një punimi studimor - hyrja, trunq ose pjesa kryesore dhe përfundimi. Në kuadër të trunqut kisha vënë theksin te shtjellimi dhe diskutimi, e si rrjedhojë e këtyre të vinte përfundimi (rezultati i studimit). E kisha tërhequr vëmendjen dhe kisha inkurajuar "mendimit kritik". Nga kjo qartë shihet prirja për të nxitur shqyrtimin kritik dhe diskutimin e asaj që shtrihet në shtjellim për të arritur te rezultatet. Midis shtjellimit dhe rezultatit kisha nënvizuar nevojën e pjesës së diskutimit, që domethënë se "rezultati" duhet të rrjedhë nga "diskutimi" e jo vetëm nga "shtjellimi". Ky është një rrjedhim tre-relacional.

Që atëherë kanë kaluar dhjetë vjet, e në trojet shqiptare gjithandej janë themeluar plot e përplot universitete - institucione publike e private, dhe bashkë me këtë është rritur edhe korpusi i punimeve studimore, të cilat, çdo vit, janë me qindra e ndoshta me mijëra. Për shumë vite kam qenë dhe vazhdoj të jem afër me rrjedhat e punimeve studimore, edhe për faktin se kam ligjëruar në disa universitete, kryesisht lëndën Shkrimi Akademik dhe Metodologjia e Hulumtimit Shkencor, Epistemologjia dhe Etika. Gjatë këtyre viteve kam parë shumë, kam kuptuar dhe kam mësuar shumë lidhur me qasjet, prirjet dhe mënyrën se si bëhen punimet studimore (si punime seminari, ese, tema bachelor, master apo doktoratë). Ajo që më ka tërhequr vëmendjen në punime të tilla ka qenë se si bëhet realizimi i tyre nga aspekti metodologjik dhe akademik, për çka kam bërë shqyrtime, analiza e njohje me probleme të ndryshme shkencore të cilat ndër vite i kam mbajtur shënime. Këtej kam shquar disa mangësi, që nuk janë të rastit, as thjesht teknike, por janë komponentë themelor, që përsëriten dhe janë thuhet karakteristike sa që shkrimi i punimeve studimore sikur është bërë një prodhim serik, si një lloj shablloni, me shumë pak kreativitet, aty-këtu ndonjë mendim kritik i ndërfaqur dhe, thuhet si përjashtim, pjesa shqyrtuese ("diskutimi"). Këto, në një farë mënyre, janë shndërruar në standarde, pasi që shumica e punimeve prej të cilave merret titull shkencor mbeten në suaza të kornizave të tyre. Pikërisht këto mangësi dua t'i vë në shënjestër, t'i theksoj, dhe përmes një qasjeje kritike të hedhë dritë në to dhe të japë një impuls, një nxitje e shtytje që të shkohet më tutje, të tejkalohet kjo gjendje dhe të bëhet një punë më e mirëfilltë studimore.

Për të kuptuar natyrën e çështjeve që do të ngritën dhe do të shqyrtohen duhet theksuar se punimet të

cilat do të vihen në shënjestër këtu janë të karakterit teori-bazuar dhe jo teori-kërkues. Te kjo e fundit, dihet, qasja është krejt tjetër, si nga aspekti metodologjik, ashtu edhe nga aspekti shtjellues, shqyrtues dhe arritja te përfundimet. Punimet studimore teori-bazuar janë ato që dominojnë. Kjo është një frymë e studimeve bashkëkohore e botës akademike dhe universitare në pjesën më të madhe të vendeve të botës, e që edhe universitetet në trevat shqiptare janë përcaktuar për studime të tilla, pra teori-bazuar. E tërë ajo që do të shkruhet e thuhet në këto shqyrtime ka të bëjë, pra, vetëm me këtë lloj të punimeve studimore universitare dhe akademike. Liria akademike nuk nënkupton studimin dosido; ajo të krijon hapësirë për të ndjekur një strukturë të caktuar - sigurisht jo një të vetme, por një të tillë që buron dhe është në përputhje me natyrën dhe karakterin e një studimi, duke ruajtur thelbin shkencor në aspektin metodologjik, teorik dhe përmbajtësor.

I. HYRJA DHE PROBLEMET THEMELORE TË SAJ

Mënyrat se si mund të formulohet një hyrje në një studim janë të larmishme dhe nuk ka ndonjë përkufizim të rreptë, që të kishte duhet zbatuar me patjetër. Megjithatë, ka një logjikë që duhet ndjekur. Struktura e hyrjes duhet të përgatis teorikisht dhe metodologjikisht mirë e mirë studimin që do të ndërmerret, duke punuar me shumë kujdes, duke i parashtruar të gjitha aspektet e nevojshme dhe të domosdoshme, ashtu që ato të drejtojnë studimin në mënyrën e duhur.

Për të krijuar një rregull mbarështrimi shumë universitete kanë hartuar udhëzues, përmes të cilëve distribuohen dhe sugjerohen standarde thuhet të njëjta, me pak dallime, lidhur me strukturën e hyrjes së një punimi studimor (temë masteri apo temë doktorate). Struktura e hyrjes zakonisht është kjo: titulli i temës, qëllimi i studimit, objektivat e studimit, pyetjet studimore, hipotezat, teoritë, metodologjia, etj. Në vazhdim do të përqendrohem te pjesët përcaktuese të një studimi, konkretisht te titulli i temës dhe qëllimi, objektivat, pyetjet studimore dhe hipotezat. Të tjerat, përfshirë edhe çështjen e metodologjisë, do t'i shqyrtoj si probleme në kapitujt në vazhdim.

1. Hyrja duhet të tregojë kahet e studimit

Për çdo njohës të punimeve studimore universitare është e qartë se është bërë një përparim në aspektin e qartësisë së parashtrimit të hyrjes së një studimi. Te ne ekziston një traditë e përhapur gjerësisht që një punim të hapet me "parathënie",

ashtu sikurse kësaj tash po ia zë vendin "hyrja".

Në studimet e sotme universitare "hyrja" është bërë praktikë e re; ajo është pjesë integrale thuhet e çdo studimi. Studimi, në një farë mënyre, nuk mund të kuptohet si duhet pa një hyrje, sepse është pikërisht kjo pjesë që tregon qartë se çka do të përmbajë, si do ta realizojë dhe çfarë pritet nga studimi, që pason.

Pavarësisht se si do të quhet pjesa hyrëse e një punimi, ajo duhet të jetë e tillë që të parashtrijë, në mënyrë ravijëzuese, kahet e studimit në mënyrë të qartë dhe të rrjedhshme metodologjikisht.

Në të vërtetë, çështja kryesore që duhet të përmbajë "hyrja" është parashtrimi i problemit studimor.

2. Kuptimi i problemit studimor

Këtu do të rrekem me çështjen themelore të "hyrjes", për të cilën, dua të theksoj, se është ndoshta ndër pjesët që zakonisht duket më e realizuara dhe që formalisht ndjekë, pak a shumë, standardet bashkëkohore të studimeve. Por unë kam përshtypjen se shpesh nuk është e qartë rëndësia e "hyrjes", ndonëse kjo është, në një farë mënyre, pjesa përcaktuese e çdo studimi.

Çka është ajo që e bën "hyrjen" kaq të rëndësishme dhe përcaktuese? Përgjigjja më e shkurtër e mundshme është - problemi studimor.

Këtu shfaqet një sfidë tjetër, që në shumicën e rasteve as që kuptohet drejt. Çështja është kjo: në çka konsiston problemi studimor, cilët janë komponentët e tij, prej se përbëhet ai?

Për ta thjeshtësuar sqarimin po theksoj se problemi studimor përbëhet nga dy aspekte - nga aspekti teorik dhe nga aspekti metodologjik.

Për problemin metodologjik do të flas më vonë, fill pas këtij kapitulli në këtë shqyrtim, kurse këtu dua të përqendrohem vetëm te aspekti teorik i problemit studimor.

Aspekti teorik i problemit studimor ndonjëherë identifikohet me pyetjet studimore, ose me qëllimin, ose me objektivat, ose me hipotezat; më e zakonshme është identifikimi me pyetjet studimore. Në fakt, problemi studimor është më kompleks se secila prej tyre marrë veç e veç.

Aspekti teorik i problemit studimor nuk është një formulim i thjeshtë. Ai është një strukturë komplekse dhe i përfshinë të gjitha ato që u përmenden më sipër. Kështu, aspekti teorik i problemit studimor ka këtë strukturë: përbëhet nga qëllimi i studimit, objektivat, pyetjet studimore dhe hipotezat. Të gjithat këto, marrë së bashku, natyrisht përfshirë edhe teorinë ku do të bazohet studimi, përbëjnë tërësinë e aspektit teorik të problemit studimor. (Vijon)

Diplomatët rusë dhe amerikanë takohen pas samitit në Helsinki

MOSKË, 4 KORRIK - Rusia dhe Shtetet e Bashkuara u pajtuan që diplomatët e tyre të lartë të takohen pas samitit të presidentëve të të dyja vendeve që do të mbahet këtë muaj, tha ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov.

Lavrov tha se takimi i tij me sekretarin amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, do të zhvillohet pas bisedimeve midis Vladimir Putinit dhe Donald Trumpit, në Helsinki, më 16 korrik. "Jemi pajtuar që datën dhe vendin ta zgjedhim pas

takimit të presidentëve tanë në Helsinki" tha Lavrov. Marrëdhëniet midis Moskës dhe Uashingtonit janë të tensionuara keq për shkak të aneksimit të gadishullit ukrainas të Krimesë nga Rusia, rolit të Moskës në luftërat në

Siri dhe lindje të Ukrainës, si dhe ndërhyrjes së saj në zgjedhjet presidenciale në ShBA në vitin 2016. Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha se Putini është i gatshëm për kompromise me Trumpin për të gjitha çështjet,



përveç statusit të Krimesë, të cilën Moskë e konsideron pjesë të saj.

Merkeli shmang rënien e Qeverisë

BERLIN, 4 KORRIK - Konservatorët e kancelares gjermane, Angela Merkel, e tejkaluan një mosmarrëveshje për migrimin, që kërcënonte ta rrëzonte koalicionin e saj të brishtë qeverisë. Bisedimet e fundit e bindën ministrin e Brendshëm, Horst Seehofer, të heqë dorë nga kërcënimet e tij për dorëheqje.

Duke dalë pas pesë orësh bisedime, Seehofer, udhëheqës i Unionit të Krishterë Social, u tha gazetarëve se do të mbetet në postin e tij, pas arritjes së marrëveshjes me Demokristianët e Merkelit, e cila, sipas tij, do ta zgjidhë migrimin e paligjshëm. "Pas diskutimeve intensive, kemi bërë marrëveshje se si ta parandalojmë migracionin e paligjshëm në kufirin midis Gjermanisë dhe Austrisë", tha Seehofer.

Marrëveshja, e cila e solli Qeverinë e Merkelit në prag të kolapsit vetëm tre muaj pasi u formua, e mban atë në detyrë. Por, pozicioni i udhëheqës që ka dominuar politikën evropiane për 12 vjet e gjysmë, duket se është dobësuar dhe kjo ngre dilema nëse ajo do të arrijë ta përfundojë mandatin.

Merkeli tha se është gjetur një "kompromis i mirë" me ministrin Seehofer, i cili kërkoi të drejtën për t'i kthyer prapa migrantët e



Marrëveshja, e cila e solli Qeverinë e Merkelit në prag të kolapsit vetëm tre muaj pasi u formua, e mban atë në detyrë. Por, pozicioni i udhëheqës që ka dominuar politikën evropiane për 12 vjet e gjysmë, duket se është dobësuar dhe kjo ngre dilema nëse ajo do të arrijë ta përfundojë mandatin

paligjshëm në kufirin e Bavarisë. Ajo tha se u pajtua t'i forcojë kontrollin në kufirin austriak për t'ondaluar njerëzit që kanë aplikuar për azil në vendet e tjera të BE-së për të hyrë në Gjermani. Për

rrjedhje, do të ngrihen qendra transiti për t'i mbajtur migrantët derisa të mund të kthehen prapa. Këto qendra transiti do të konsiderohen vetëm për qëllime migrimi, si të mos jenë në

Gjermani, për ta bërë më të lehtë dëbimin apo kthimin e migrantëve. Marrëveshja e kompromisit nënkupton se Seehofer është në gjendje të bëjë kontrolle më të forta

të migracionit, ndërsa Merkeli mund të thotë se Gjermania u përmbahet rregullave të Bashkimit Evropian dhe se respekton lirinë e lëvizjes brenda bllokut. "Fryma e partneritetit në Bashkimin Evropian është ruajtur dhe njëkohësisht është bërë një hap i rëndësishëm", u tha Merkeli gazetarëve. Por, kriza në Gjermani është një tjetër shenjë e ndarjes në mbarë BE-në midis atyre që duan të mbanin kufij të hapur dhe atyre që duan ta kufizojnë numrin e migrantëve që hyjnë në bllok.

Qeveria në Vjenë reagoi duke thënë se do të përgatisë masa për t'i mbrojtur kufijtë e saj jugorë dhe se do të kërkojë një sqarim të shpejtë të vendimit të Gjermanisë.

Javën e kaluar, zëvendëskancelari i Austrisë, Heinz-Christian Strache, nga partia e ekstremit të djathtë Liria, tha se nëse Gjermania një ditë i kthen prapa migrantët, Austria do të jetë gati për sigurimin e kufijve.

Qeveria e Austrisë, e cila më 1 korrik mori presidencën e radhës të BE-së, ka qëndrim të ashpër ndaj migrantëve. Njësoj qëndrojnë edhe fqinjët e Grupit të Vishegradit: Republika Çeke, Sllovakia, Hungaria dhe Polonia. Ky grup, prej kohësh, e ka kundërshtuar një skemë të BE-së për të pranuar refugjatë nga kampet e mbipopulluara në Greqi dhe Itali.

Trumpi do ta emërojë diplomaten Kavalec ambasadore në Shqipëri



WASHINGTON, 4 KORRIK - Presidenti Donald Trump njoftoi synimin për ta emëruar Kathleen Ann Kavalec nga Kalifornia ambasadore e ShBA-së në Shqipëri, njoftoi Shtëpia e Bardhë.

Kavalec aktualisht shërben si zëvendësndihmës Sekretare në Zyrën e Çështjeve Evropiane

dhe Euroaziatike në Departamentin e Shtetit me mbi tri dekada përvojë si diplomate. Më parë ka shërbyer drejtoreshë e Zyrës së Çështjeve të Rusisë, zëvendës shefe e Misionit të ShBA-së në UNESCO në Paris, zëvendës koordinatore e ndihmës në Zyrën e Çështjeve Evropiane dhe Drejtore për

Parandalimin e Konfliktëve në Zyrën e Koordinatorit për Rindërtimin dhe Stabilizimin. Kavalec ka mbaruar Universitetin e Kalifornisë në Berkeley dhe ka një master nga Universiteti Georgetown. Flet rrjedhshëm gjuhën frënge, rumune, ukrainase, ruse, spanjolle dhe portugeze.

Rohani: Askush nuk përfiton nga tërheqja prej marrëveshjes bërthamore

VIENË, 4 KORRIK - Presidenti i Iranit, Hassan Rohani, përsëriti se Teherani do të vazhdojë ta respektojë marrëveshjen bërthamore të vitit 2015 për aq kohë sa interesat e saj garantoohen edhe nga nënshkruesit e tjerë.

Duke folur në Vjenë, pas takim-

it me homologun austriak Alexander Van der Bellen, Rohani tha se tërheqja e Shteteve të Bashkuara nga marrëveshja, dy muaj më parë, ka qenë e paligjshme. "As ShBA-ja, as edhe një vend tjetër nuk do të përfitojë nga vendimi për tërheqje nga marrëveshja", tha

Rohani.

Presidenti amerikan Donald Trump e ka tërhequr ShBA-në nga marrëveshja në muajin maj dhe ka rikthyer sanksionet kundër Iranit. Me këtë marrëveshje Irani e ka frenuar aktivitetin bërthamor në këmbim të lehtësimit të sanksion-

eve ndërkombëtare. Më 6 korrik ministrat e jashtëm të Iranit dhe pesë vendeve të tjera nënshkruese të marrëveshjes: Britanisë, Francës, Rusisë, Kinës dhe Gjermanisë do të takohen në Vjenë për të diskutuar mënyrat për ruajtjen e traktatit.



SHUMËLLOJSHMËRIA E ESESË

(Prend Buzhala, "Kosova pas luftës së katërt botërore", ese, këndshikime, vëllimi i parë me titullin e përbashkët 'Vjaskat e moteve', Prishtinë, 2018)

Idriz BERISHA

Autori Prend Buzhala, përpos poezisë, prozës, studimeve letrare, kritikës letrare e publicistikës, e shkruan dhe e krijon me sukses edhe zhanrin interesant të esesë e të eseistikes përgjithësisht. Kështu, në mesin e 52 titujve të veprave origjinale dhe të mbi dhjetë të tjerave që i ka përgatitur për shtyp, hyjnë edhe librat me ese si: Res Publica e shkrimtarit, (Ese, trajtesa), 2008, Muza e Kujtesës, 2007. Botimi II, 2012. Me sibilën e esesë (ese letrare), 2015, Muza e dhjetë, ese, 2015, Katarza e ripërtëritjes, ese, 2017, Në herodiumin modern (pesëdhjetë ese), 2018 dhe vëllimi i fundit me ese "Kosova pas luftës së katërt botërore".

Ky vëllim përfshin 185 ese, që ndahen në pesë cikle. Librit i prin eseja "Në vend të hyrjes: Kokrriza kohe (Çast në një triptik rrjedhash enigmatike të jetës dhe motit), kurse pesë kapitulat tjera të këtij libri janë: I. Letra nga mësuesja e madhe e jetës, (Esetë 1- 80)

II. Sokrati i numëron shpifësit e tij (esetë 81 - 94)

III. Kronotopi i udhëtimit (esetë 95-101)

IV. Kosova pas luftës së katërt botërore (esetë 102 - 141) dhe V. Sintagma kulturore (esetë 142 - 185).

Në nëntitullin shpjegues të librit autori ka vënë shënimin "Vjaskat e moteve, ese, këndshikime Vëllimi I). Kjo do të thotë se eseja merr karakterin një ditari meditativ, eseistik, ndër mote, që i ruan gjurmët e reagimeve autoriale.

1. Struktura e librit


Që në hyrje lexojmë shënimin sqarues: "Gjatë viteve '80 dhe '90 (të shekullit të e lamë pas), në fletoret e shënimeve mbaja këso komentesh të shkurta (tash në rrjetin social quhen edhe status-tekste). Ato përbëjnë disa vëllime. Disa prej tyre i pata

botuar (një si përzgjedhje) në gazetën "Bashkimi" të Prishtinës më 1991 dhe në revista lokale të Klinës... Aso kohe i quaja vjaska të moteve (Vjaska, sipas Fjalorit: "E thelluar e ngushtë në sipërfaqen e diçkaje; e çarë, plasë.") Por ka domethënie edhe të rathëve të një lisi nëpër mote, në prerjen horizontale e vertikale. Dhe në diskursin e tillë të shkrimit komentues-eseistik, të lirshëm, iu ngjet atyre grafikoneve të kohës, për të krahasuar paralelisht kohët, datat, vitet... Metrika e këtyre shënimeve, në përjasje me të tashmen, të paktën, i ruan ato shenja, rrjedha, vjaska..." Mirëpo, magjia e e shkrimit të esesë e ndërthen edhe një dimension tjetër, që po ashtu autori reflekton në këtë hyrje:

"Eseja është si një rrjedhë që nuk ndalon në kohë, ecën përtej kufijve, përtej secilit kufi... Retë sulen sipër lumenjve të dritës, për të vallëzuar në kohë. A është moti ai që shkon, apo jemi ne që lëvizim dhe ikim? Ngjet mu si me retë që shtegtojnë e hapësira e qiellit mbetet aty. Dhe jeta ka rrjedhën e saj, mu si ujët e lumit. E lumi mbetet aty, nuk ecën. Nuk mund t'i ngjash lumit pa ujë a kohës pa njerëz."

Në ciklin e parë përfshin ese të karakterit spiritual, meditativ, kulturologjik, estetik dhe të labirinteve të qenies njerëzore. Ja titujt e pesë eseve të para: 1. Përmasat e të pashprehshmes në gjuhë... 2. Në trokitjet e së bukurës, 3. Mbi qytetërimin e lirisë, 4. Ç'është muza dhe 5. Një dekalog-skicë, për vuajtjen në botë.

Cikli i dytë, ashtu sikundër sugjeron edhe titulli, janë ese që për baze trajtimi marrin sulmet ndaj intelektualit, duke u personifikuar te figura e Sokrati, Mbi fenomenin e Invektivës (Shkrimi a e të folurit me fyerje, Sharje e gjuhë negative, mbi shoiqjebn si fenomen që e përcjell karakterologjinë e shoqërisë sonë. ja si mediton autori: "Në shoqërim me të ligën që mbi-zotëron në shoqërinë tonë, dorë



përdore me vlerat demokratike e njerëzore, ecin edhe shpifja, e pavërteta apo mashtrimi, që i kanë protagonistët e Kryeprogonistët e vet të shumë qoftë tek organet udhëheqëse apo tek partitë politike, qoftë tek zyrtarët e thjeshtë apo specialistët, tek njerëzit e arsimuar, por edhe tek ata që kanë një arsim të pakët. Gënjejnë, mashtrojnë dhe shpifin, si bota mashkullore, ashtu edhe ajo femërore. Gënjejnë, mashtrojnë dhe shpifin edhe meset e institucioneve arsimore, shkollore e edukuese, ashtu sikundër gënjejnë, mashtrojnë dhe shpifin, madje, edhe qarqet fetare!" disa ese të tjerë të këtij kapitulli mbajnë titujt: Nga qyqaria te guximi qytetar, Nga bizneskolaboracionizmi te kolaboracionizmi politik, Në antitezën e jetës (Çaste shkrimi: fjala, dëgjimi, bëmat, historia) dhe Në kërkim të lumturisë.

Interesantë janë edhe qerthulli i eseve të ciklit të tretë që i kushtohen udhëtimit, shtegtimit, siç janë esetë: Secili udhëtim është një dhuratë dhe një bekim më vete, Sinonim i fjalës udhëtim është fjala turizëm (Çaste eseistike: nga Bajroni te e sotmja), Udhëtimi, bota si në shuplakë të dorës dhe Kush është i lirë të udhëtojë sot?

Rreth 40 ese përbëjnë ciklin e katërt, sipas të cilit ka marrë edhe titullin libri: Kosova pas luftës së katërt botërore. Janë ese që i kushtohen situatës

së sotme e të djeshme në Kosovë, në shpalimet e labirintet e fatit kolektiv ekzistencial dhe historik, shpalime të karakterit politik, shoqëror, po edhe shtetëror në pëqarasje nacionale e ndërkombëtare. Janë vënë në fokus orientimet tona të shkapërderdhura kah perëndimi e kah lindja, përbashkët me armiqtë e sot. Ja disa tituj karakteristikë të këtij cikli: Dresura politike, Kosova i ngjet në një anije të dehur, Një shtet si karantinë, Kosova: Përtej një ëndrre utopike, Ka humbur masa akseologjike e vlerave, Patriotizmi në (anti)vepër, Ose zhdukja e kujtesës urbane, Fobitë e shtresuara nën sundues të huaj, Kur partitë politike klerikalizohen, Paradoksi i zgjedhjeve tona: Qytetari, i përfaqësuar pa deputetë!, Në Evropë nuk bën të jesh dakord me të keqen a me regresin historik, Drenica dhe shpirti i madh pajtimtar etj.

Vjen cikli i fundit me titullin "Sintagma kulturore" e ku disa shkrime shpesh edhe kapërcëjnë caqet e një eseje dhe marrin formën e një studimi të mirëfilltë. Aty trajtohen figura si Buzuku dhe Naimi, Fishta dhe Konica, don Shtjefën Kurti dhe Dritëro Agolli, Frederik Reshpja e Robert Elsie. Vijnë tekste homazhesh për poetë, gazetarë e stivues si Tahir Desku dhe Agron Bala. Me çështje të gjuhës e të fjalës merret me esetë Mbi gjuhën standarde shqipe, Mbi kombin me dy emra (Në shtatë kundrimet) dhe Fjala shqipe "fis" e papërkthyeshme. Kurse esetë në formë studimesh si "Letërsia e vjetër shqipe, më e përkthyer dhe më e studiuar", apo "Kujtesë: sipas gaius plinius secundus, romakët e morën alfabetin nga ilirët", "Mbi petitionin kundër ndryshimit të historisë" dhe "Ligjëratë interesante: Udhëpërshkruesit në Kosovë në shekujt XIV-XX" E John Hoxhson, studiues dhe përkthyes nga Britania e Madhe" përbën një qerthull temash të fahut të tij si studiues letrar deri tek profili i një historiani të letër-

sisë. Autorin te disa ese e preokupon fenomenologjia e pushtuesve si mendësi e shtresuar te kolektiviteti ynë nacional (esetë "Mendësia tragjike e paralelizimeve", "Paradokse historike...", "Historia: ish-Jugosllavia dhe perandoria otomane", "Fenomeni i dashurisë ndaj armikut ose "Indromi i Stokholmit" dhe "Hijet e rënda të pushtuesve"). Kurse esetë si "Duke qenë sa më shqiptar, aq më shumë largohemi nga orienti" dhe "Atdheun duhet ta duam pa kushte" apelon për një qasje plot vull, zjarr e energji të pashtershme që duhet t'i vëmë në shërbim të të mirës sonë të përbashkët e që quhet Republikë e Kosovës. Në fund, në vend të përfundimit, vjen eseja "Sfidimi i vështirë i vetvetes dhe kohës".

2. Përmbyllje

Si një sfidim të tillë autori e merr edhe formën e esesë që e trajton, duke u shprehur: "Ti polemizon me kohën. Ballafaqohesh me idetë e ngurta shoqërore a të njerëzve. Me paragjykimet e ngurta, që e ngushtojnë botën te një premisë tragjike... Koha gjithnjë thur rreziqe të reja e ti iu hyn atyre. Ndjesia e rrezikut është emocionuese. Sfidat është gjetja e rreziqeve të reja... Sfidimi na qenka shtegu për ecjen përpara në jetë!"

Do theksuar se eseja e Buzhalës argumentohet e stoliset me citate të shumta nga autorë botërore, qofshin ata filozofë, teologë, shkrimtarë, politikanë, artistë, sportistë, muzikantë... me një fjalë, njerëz të të gjitha profileve. Ky ese dallohet për shkurtësinë tekstuale të trajtimit, për të mos e lodhur lexuesin me stërzgjatje të panevojshme. Shkurtësia është mëma e një teksti të përpunuar mirë e me kujdes.

Prandaj ato lexohen si një s h u m ë l l o j s h m ë r i preokupimesh, meditimesh, reagimesh, trajtimesh dhe zbërthimesh.

Ministri Gashi i ofron përkrahje Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota"

PRISHTINË, 4 KORRIK (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur në takim përfaqësues dhe valltarë të Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota", pas pjesëmarrjes së tyre të suksesshme në Festivalin Ndërkombëtar "Vitosh Folk Fest 2018", në të cilin u shpërblyer me tri çmimet kryesore të festivalit.

Ministri Gashi ka uruar ansamblin për çmimet e marra dhe i ka përgëzuar ata për punën që po

bëjnë për promovim të traditave muzikore shqipe. "Për mua është një kënaqësi e veçantë kur ka rezultate të mira. Na keni bërë të ndihemi mirë si MKRS, si pjesë e juaja në kuptimin institucional. Ju përgëzoj për arritjet dhe për çmimet që keni marrë", ka thënë Gashi. Ai ka shtuar se rezultatet e arritura të Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota", MKRS-në e bëjnë të ndihet krenare, sidomos rezultatet e arritura në gara të mëdha jashtë ven-

dit. Ushtruesi i detyrës së Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota", Nazmi Demaj, ka falënderuar ministrin për pritjen. "Ne çdo herë kemi sjell nga jashtë çmime, në të gjitha garat në të cilat kemi marrë pjesë, jemi shpërblyer me çmime të para e të dyta", është shprehur Demaj.

Ndërkaq profesori nga Shqipëria, koreografi Fehmi Shaqiri, u shpreh i kënaqur me pritjen e ministrit Gashi. Duke folur për sukseset dhe



të arritura e Ansambllit "Shota", Shaqiri ka theksuar se si Ansambël kanë folklor shumë të madh. "Nuk

ka ambasador më të madh dhe më të fuqishëm sesa Ansambli 'Shota', ka thënë Shaqiri.

E rrallë

Treni vishet me simbolet e 'Hello Kitty'-t

Treni i plumbit "shinkansen" kushtuar "Hello Kitty"-t ka bërë "debutimin" në Japoni. Me udhëtimin e parë ndërmjet Osakës dhe Fukuokës, me trenin rozë synohet tërheqja e sa më shumë turistëve. Treni plumb në fakt është shndërruar në një kënd lojërash, pasi edhe



brenda tij gjithçka është modifikuar për t'i bërë reklamë personazhit "Hello Kitty".

BARSOLETA E DITËS



Dy policë, teksa kalojnë pranë maternitetit, lexojnë një letër.
 Tre profesionet më të rrezikuara nga sifilizi:
 - Aktorët, shoferët, policët.
 Njëri pyet tjetrin:
 - Ç'është ky sifilizi?
 Ia fut shuplakë i pari:
 - Shkaku i budallenjve si puna jote jemi në vend të tretë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



FOTO E DITES



Fëmijët afganë mbledhin mbeturina në periferi të provincës Herat. /AFP/

Në ora 18:20

"FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

"ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



E jashtëzakonshme

Del në ankand avioni i braktisur i Elvis Presleyt

Në kohët e arta Elvis Presley kishte tre aeroplanë. Mementalisht dy janë në Graceland, në shtëpinë e ish-rokerit të famshëm në Memphis, Tennessee. Një, në pronësi private, është mbajtur për 36 vjet në aeroportin e vogël të Rosvelit në Nju Meksiko dhe do të dalë në



shitje në internet me një çmim të vlerësuar rreth 2-3 milionë dollarë. Ofertat do të pranohen deri më 27 korrik.



Në ora 22:00

"LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.

 <p>DASHI Sot duhet të konsideroni të keni disa ballafaqime mendimesh me persona që ju kanë mbështetur, por nuk kanë marrë të njëjtën mbështetje prej jush.</p>	 <p>DEMI Mos lejoni që personat pranë jush të vuajnë për një sjellje të pashpjegueshme tuajën. Mbase duhet ta dinë se pse keni marrë këtë lloj sjelljeje.</p>	 <p>BINJAKËT Sot do të kërkonit shoqëri në një udhëtim të këndshëm që keni vendosur të bëni. Mund të ftoni këdo sepse do t'ju bashkohet menjëherë.</p>	 <p>GAFORRJA Lërimi pas dore iniciativat tuaja sot dhe prisni që të tjerët t'ju ftojnë për ta dhënë kontributin tuaj. Në çështjet e zemrës ka dyshime.</p>	 <p>LUANI Jo gjithmonë mund të kërkohet ndihma juaj, por është mirë që në ato çaste që dikush shprehet t'i gjendeni pranë për ta ndihmuar.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Duhet të jeni më larg-pamës dhe të mos mendoni gjithmonë sot për nesër. Projekte të rëndësishme priten në horizont.</p>
 <p>PESHORJA Gjithmonë keni zgjedhur të shkoni kundër rrymës dhe kjo ju ka sjellë mjaft kënaqësi personale, por ka vënë në dilemë miqtë tuaj për zgjedhjet e bëra.</p>	 <p>AKREPI Nëse nuk ju intereson të jeni pjesë e situatave të caktuara do të bënit mirë të mos përfshiheni edhe në debate që kanë të bëjnë me këto situata.</p>	 <p>SHIGJETARI Nëse nuk doni të viheni në garë me dikë nga kolegët duhet të hiqni dorë njëherë e mirë nga ambiciet tuaja që nuk keni mundësi as t'i realizoni.</p>	 <p>BRICJAPI Këtë periudhë jeni shumë të shpërqendruar midis gjërave të punës dhe jetës familjare sa në shumë momente doni të hiqni dorë nga gjithçka.</p>	 <p>UJORI Keni shumë nevojë kohët e fundit, por për momentin nuk do të mund të realizoni asnjë prej tyre. Për një kohë të gjatë do të jeni nën stres.</p>	 <p>PESHQIT Nëse nuk jeni të interesuar t'i dëgjoni këshillat që po ju jep një miku juaj mund të tregoheni të sinqertë me të dhe t'ia thoni për atë që po ndieni mungesë.</p>

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

OESTE - GUARANI

1

AVAI - GOIAS

GG

CRB - SAO BENTO

1

